

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE MATERIALE INERTE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Struktura në ndërtim dhe materiale; produkte ndihmëse ndërtimi (përveç aparateve elektrike)
44000000-0

Vlera e parashikuar e fondit limit : 14,944,673.33 (katërmbedhjetë milion e nentëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) **leke pa TVSH.**

Argumentimi: Perilogaritja e vlerës së fondit limit është bërë referuar Nenit 35 të Ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 të VKM 285 datë 19.05.2021, të ndryshuar

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë elektronikisht Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 duke e plotësuar bashkëlidhur me një deklaratë Referuar Ligji 16/2024 “Për disa

shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” , Operatori ekonomik duhet te kete të regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; operatori ekonomik duhet te kete përmbushur detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për pagat; operatori ekonomik nuk duhet te kete asnje anëtar te një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, i operatorit ekonomik, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij; te dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): **Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 43, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të të ardhurave.

Percaktimi i vleres se kerkuar argumentohet si me poshte;

Pika 1 dhe pika 2/b, neni 43 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet, përkatësisht; Pika 2/b: *vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;..* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me parë, rëndësisë së objektit të prokurimit, rëndësisë së Autoritetit Kontraktor, seriozitetit të marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë me aktivitet të vazhdueshëm në treg gjykon se është e përshtatshme vendosja e këtij marzhi të përcaktuar në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

2.2.2. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 te konfirmuara nga admnistrata

tatimore, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rastin e Bashkimit të operatorëve ekonomikë, Operatorët duhet të përmbahen përcaktimet të nenit 88 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4 si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të cilësisë (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- b. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).

Të cilat të përfshijnë objektin e prokurimit, si dhe të jenë të vlefshme. Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). *Certifikatat kërkohej të jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën të 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

AK, bazuar në dispozitat më sipër cituar dhe kërkesat e specifikimeve teknike, dhe preventivit të furnizimeve, ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit (Certifikatat ISO) dëshmuar të pajtueshmërisë së ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. Certifikatat ISO të kërkuara nga AK lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikën e furnizimit të shtjelluara dhe zgjidhura në preventivin përkatës.

Në vijim shtjellohen certifikatat ISO të kërkuara nga AK.

- **ISO 9001:2015.** Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”.

ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë: duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme. synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.

- Cerifikata për sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001:2015** e kërkuar nga AK garanton se OE ofrues do të sjellë produkte të cilat nuk demtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standarteve ndërkombëtare të cilësisë. Kërkesa në lidhje me këtij certifikatë është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79, të Nr 162, datë 23.12.2020 “Për rregullat e prokurimit publik”.

2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të kete ne pronesi ose me kontrate noteriale furnizimi, kontrate qeraje, per inertet dhe betonin: lejen e ndërtimit dhe autorizim mjedisor (leje) për aktivitetin: Impiant prodhim betoni (QKL Kodi: III.2.B).

- Per Inertet
- Betonin

Afati i kontrates se furnizimit te mbuloje të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për përmbushjen e ketij kriteri duhet të paraqes lejen e ndërtimit dhe autorizim mjedisor (leje) për aktivitetin: Impiant prodhim betoni (QKL Kodi: III.2.B). (vetiake ose me qera)

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur bazuar ne nenin 77/1/C dhe 77/4 te ligjit nr. 162/2020, Per prokurimin publik, e cila ka lidhje teknike me objektin qe prokurohet dhe eshte proporcionale me objektin e kontrates. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Kjo kerkese gjithashtu eshte vendosur bazuar dhe ne nenin 79/1 te ligjit nr. 162/2020, Per prokurimin public.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion vetshkarkues	Cope 2	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine vetshkarkuese 3.5-7.5 ton	Cope 1	Ne pronesi ose me qera
Fadrome me goma	Cope 1	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	Cope 2	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me goma	Cope 1	Ne pronesi ose me qera
Autopompe betoni	Cope 1	Ne pronesi ose me qera
Asfalt shtrues	Cope 1	Ne pronesi ose me qera
Rrul	Cope 1	Ne pronesi ose me qera

Makinerite dhe pajisjet duhet te jene ne pronesi ose me qera, të cilët duhet ti vërtetojë:

- me leje qarkullimi,
- çertifikatën e kontrollit teknik dhe
- siguracionin e mjetit,
- leja e transportit nga Bashkia apo Komuna për vete ose të tretë
- foto.

Githashtu dhe për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet:

- a) leje qarkullimi,
- b) certifikatën e kontrollit teknik
- c) siguracionin e mjetit,
- d) foto.
- e) leja e transportit nga Bashkia apo Komuna për vete ose të tretë
- f) kontratën përkatëse të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu ky kriter e siguron autoritetin kontraktor duke i dhënë garanci që i gjithë malli objekt prokurimi do të transportohet në mënyrë të sigurt për në ambientet e Autoritetit Kontraktor. Te gjitha mjetet e kerkuara kane lidhje teknike me zerat e mallrave objekt prokurimi, si dhe jane te domosdoshme per permbushjen me sukses te kontrates.

-Kamion vetshkarkues do te sherbej per transportin e inerteve (rërë, zhavorr, materialetet e ndertimit) nga guroret ose furnitori deri në impiantin e betonit apo vendin e punimeve. Gjithashtu Sigurojne fleksibilitet dhe akses në terrene të vështira, duke garantuar furnizim edhe në segmente të vogla të punimeve.

-Fadroma me goma do te sherbej per ngarkimin dhe shkarkimin e inerteve në kamionë, si dhe menaxhon stokun e materialeve në impiant.

-Autobetoniere do te sherbej per transportin e betonit nga impianti deri në vendin e kryerjes se punimeve jane kerkuar 2 cope pasi shtrirja territorial e Shoqerise perfshin Bashkine KRUJE,RRogozhine,Kavaje,Shijak Durres.

- Autopompë betoni do te sherbej per pompimin e betonit në lartësi ose distanca ku autobetonieria nuk mund të arrijë.

-Asfalt-shtrues do te sherbej per shtrimin e asfaltit në rrugë. Pa këtë pajisje, asfaltimi nuk mund të kryhet sipas standardeve teknike. Pajisja është e domosdoshme për realizimin e kontratates.

- Rrul do te sherbej per ngjeshjen kompakte te shtresave te inerteve dhe asfaltit për të siguruar qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të strukturës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër transportin e mallit të kërkuar , pranë Autoritetit kontraktor, brenda afateve, të përcaktuara nga AK.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operator i ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu, kjo kërkohej për të siguruar Autoritetin Kontraktor që operator i ekonomik i shpallur fitues do të relizojë me mjetet e veta transportin, montimin e mallrave objekt prokurimi brenda afateve të përcaktuara në dokumentatat e tenderit.

2.4.2 Ofertuesi për mallrat objekt prokurimi:

- **Asfalt,**
- **Llac me ngrirje të shpejte 24 Mpa per 24 ore,**
- **Llac me fibra celiku me ngrirje të avashte,**
- **Llac me fibra xhami me rezistence të larte ≥ 60 Mpa**

duhet të dorëzojë Autorizim Prodhuesi, ose distributori. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori operator i ekonomik ta vertetojë këtë duke paraqitur kontratë premtimi, letër angazhimi / akt-marreveshje lidhur me Kompaninë prodhuese ose Distributorin të autorizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohej në këtë procedurë, garanton Autoritetin Kontraktor se Ofertuesi është i autorizuar për ofrimin e këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohej të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorit Ekonomik ofertues për aftësitë teknike dhe njëkohësisht i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e mundësisë së OE ofertues për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.4.3 Ofertuesi për mallrat objekt prokurimi:

- **Asfalt,**
- **Llac me ngrirje të shpejte 24 Mpa per 24 ore,**
- **Llac me fibra celiku me ngrirje të avashte,**
- **Llac me fibra xhami me rezistence të larte ≥ 60 Mpa**

duhet të paraqesë dokumenta teknike si: katalog apo fragmente katalogu dhe skemat teknike të këtyre produkteve objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Kohëzgjatja e marreveshjes kuader do të jetë 12 muaj nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të draft marrveshjes kuader.

Afati i lëvrimit të materialeve objekt prokurimi të jetë jo me vonë se 30 ditë sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NR	E M Ë R T I M I	NJËSIA	SASIA
1	Tulla te plota	copë	2000
2	Blloqe betoni 25 x 25 x40 cm	copë	300
3	Rere e lare	m ³	500
4	Cimento	kv	500
5	Çakell	m ³	200
6	Granil	m ³	100
7	Rere ose shtufe per mbulim kanali	m ³	400

8	Zhavorr lumi I lare	m3	500
9	Stabilizant	m3	800
10	Gelqere	kg	100
11	Beton M-250	m3	80
12	Llac me ngrirje te shpejte 24 Mpa per 1 ore	kg	500
13	Llac me fibra celiku me ngrirje te avashte	kg	500
14	Llac me fibra xhami me rezistence te larte 60 Mpa	kg	500
15	Profil L 50 x 50 x 2.5 mm	kg	1500
16	Profil L 80 x 80 x 5 mm	kg	1000
17	Gozhde ø 8 mm	kg	300
18	Gozhde ø 10 mm	kg	300
19	Gozhde ø 12 mm	kg	300
20	Zgare ø 10mm (10 m2)	copë	30
21	Tel 6 per zhbllokim	kg	110
22	Tel Bari per armature	kg	100
23	Hekur ø 12 per kapake betoni	kg	200
24	Hekur ø 16 per punime zgarash	kg	200
25	Hekur ø 20 per punime zgarash	kg	200
26	FV Binder 6 cm	m ²	200
27	FV Binder I mbyllur konglomerat	m ²	200
28	FV asfalt Tapet 4 cm	m ²	200